



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK DURRES

Nr. 318 prot.

Data 27.2.2025

Lënda: Njoftim për vend të lire pune

AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive"; të udhëzimit nr.759 , datë 30.09.2024 "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë , menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjes së njësive të zhvillimit të ofruesve të institucioneve ,ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit"

QFPP Durres ju njofton krijimin e vendeve të lira për pozicionet :

1. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Qendistari " prane QFPP Durres , Filiali Kruje , (1 person)
2. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Aftesi Digjitale " prane QFPP Durres , (2 persona)
3. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Berber " prane QFPP Durres , (1 person)
4. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Modelim stilim veshjesh per femra " prane QFPP Durres , (1 person)
5. Instruktor I praktikes profesionale per kursin " Rrobaqepesi " prane QFPP Durres (1 person)
6. Instruktor I praktikes profesionale per kursin "Punime pllakashtimi " prane QFPP Durres , (1 person)

7. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Instalim dhe mirëmbajtje e rrjetit elektrik" pranë QFPP Durres , (1 person)
8. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Manikyr -Pedikyr" pranë QFPP Durres , (1 person)
9. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Estetike" pranë QFPP Durres , (1 person)
10. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Administrator ndërtesash" pranë QFPP Durres , (1 person)
11. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Kujdestar social" pranë QFPP Durres , Filiali Kavaje , (1 person)
12. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Kujdestar për të moshuar" pranë QFPP Durres , (1 person)
13. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Kujdestar social" pranë QFPP Durres , (1 person)
14. Instruktor I praktikës profesionale për kursin "Parukeri" pranë QFPP Durres , (1 person)

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar,
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën:
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formë së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale, pas të mesme ose parauniversitare në të njëjtën fushë me kualifikimin/kualifikimet profesionale për të cilin/cilat po aplikon;
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit;

1. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në);
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara.

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e QFPP Durrës brenda dates

07.03.2025.

